

Projekti: Efektiviteti i mekanizmit vlerësues në kuadër të Integrimit Evropian – BENCHER



1 Janar 2017 – 31 Dhjetor 2017



QËLLIMI: Të shqyrtojë efektivitetin e mekanizmit vlerësues të BE-së për Ballkanin Perëndimor dhe të kontribuojë në përmirësimin e këtij mekanizmi si një shtysë për reformat në kuadër të integrimit në BE.



FUSHAT TEMATIKE:

- Integrimi Evropian
- Anëtarësimi në BE
- Efektiviteti i mekanizmit vlerësues



AKTIVITETET:

- Zhvillimi i një metodologjie për vlerësimin e efektivitetit të mekanizmit vlerësues;
- Analiza e raporteve të Komisionit Evropian për vitin 2016;
- Analizë për secilin prej vendeve të përfshira në projekt, vlerësim i efektivitetit të mekanizmave të vlerësimit të përdorur nga BE si dhe hartimi i një analize krahasuese në nivel rajonal.
- Aktivitete në secilin prej vendeve të përfshira në projekt; aktivitete në nivel rajonal; takime në secilin prej vendeve me institucione kombëtare përgjegjëse për procesin e koordinimit në kuadër të integrimit në BE;
- Takime advokuese me përfaqësues të shteteve anëtare të BE-së dhe përfaqësues të delegacioneve të BE-së në secilin vend;



REZULTATET:

- Pasqyrim krahasues i raporteve të KE-së për vitin 2016 për secilin prej vendeve të përfshira në projekt;
- Metodologji mbi efektivitetin e mekanizmit të vlerësimit për anëtarësim në BE të vendeve të Ballkanit Perëndimor;
- Studime për secilin prej vendeve, bazuar mbi mekanizmat e përzgjedhur të vlerësimit;
- Dokument politikash me rekomandime konkrete për përmirësimin e mekanizmit vlerësues.

Më tej, projekti do të kontribuojë në ndarjen dhe transferimin e njohurive dhe përvojës ndërmjet vendeve si dhe përmirësimin e bashkëpunimit rajonal të institutive kërkimore që punojnë mbi çështjet e integrimit Evropian, duke marrë parasysh se partnerët e vendeve të rajonit janë pjesë e këtij Projekti.

AUDIENCA E SYNUAR:

Bashkimi Evropian:

Komisioni Evropian – DP
Shtetet fqinje dhe Negociatat e Anëtarësimit;
Ministritë e Punëve të Jashtme të shteteve anëtare në BE.

Rajoni:

Zyrtarë të institucioneve përgjegjëse në koordinimin e procesit të integrimit në BE;
Komuniteti i hulumtuesve në çështje të anëtarësimit në BE
Organizata të shoqërisë civile të përfshira në çështjet e integrimit në BE;
Publiku i gjerë dhe aktorë të tjerë interesi.